

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË KUÇOVË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Kuçovë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 51, datë 30.04.2015.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 32/6, datë 30.04.2015, i ka rekomanduar z. Bardhyl Gjyzeli, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kuçovë nuk është mbajtur regjistri i raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e tyre sipas nenit 21, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Gjithashtu nuk është miratuar dhe vënë në funksionim sistemi informacioni dhe komunikimi.

1.1 Rekomandim:

a. Nga ana e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, të merren masa për hapjen dhe mbajtjen e regjistrit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

b. Për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nëpunësi autorizues të regjistrojë dhe raportojë masat e marra për parandalimin e tyre, gjithashtu të miratohet dhe vihet në funksionim sistemi i informacionit dhe komunikimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në dosjet e **9 lejeve zhvillimore** të miratuara, mungojnë: Dokumentin që vërteton identitetin e personit kërkues për leje, kontratë sipërmarrje, gen plani i hartuar nga sektori i GIS Kadastrës, plani i vendosjes së strukturës në shkallë 1:500, projekti i ngrohje ventilimit të strukturës, studim gjeolog- inxhinierik dhe hidro- gjeologjik, studim sizmologo- inxhinierik, vërtetim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, vërtetim nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim me VKM .nr 459, datë 16.6.2010 nenin 53, paragrafi a, b i nenit 70/13 të Ligjit nr 10119, datë 23.4.2009 “*Për planifikimin e territorit*” të ndryshuar.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Urbanistikës dhe Strehimit, të marrë masa dhe të plotësojë dosjet me mangësit në dokumentacionin tekniko ligjorë: dokumentin që vërteton identitetin e personit kërkues për leje, kontratë sipërmarrje, genplani i hartuar nga sektori i GIS Kadastrës, plani i vendosjes së strukturës në shkallë 1:500, projekti i ngrohje ventilimit të strukturës, studim gjeologo-inxhinierik dhe hidro-gjeologjik, studim sizmologo- inxhinierik, vërtetim nga Instituti i Monumenteve të

Kulturës, vërtetim nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjithë dokumentacioni i dixhitalizuar

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë dhe Drejtoria e Urbanistikës nuk ka administruar dhe marrë masa për një politikë aktive të menaxhimit të tokës dhe të zhvillimit në të, nuk ka drejtuar dhe nxitur programe të ndërgjegjësimit e edukimit publik, nuk ka bashkëpunuar me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, nuk ka informuar publikun për të gjithë procesin planifikues e zhvillimet në territor, nuk disponon kapacitete të mjaftueshme njerëzore për planifikimin e territorit, veprime këto në kundërshtim me pikat 1, 2 germat a,b,c, ç,d, e, dh, e, ë, f, g, Seksioni “ii” Neni 13, Ligjin Nr. 10 119, datë 23.4.2009 *“Për Planifikimin e Territorit” Ligjin 110/2013*

3.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë dhe Drejtoria e Urbanistikës të administrojë dhe marrë masa, për një politikë aktive të menaxhimit të tokës dhe të zhvillimit në të, të drejttojë dhe nxisë programe të ndërgjegjësimit e edukimit publik, të bashkëpunojë me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, të informojë publikun për të gjithë procesin planifikues e zhvillimet në territor, si dhe të rrisë kapacitete të mjaftueshme njerëzore profesionale për planifikimin e territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit në ZVRPP Kuçovë, të pronave të transferuara me VKM nr. 662, date 8.10.2004 i, ndryshuar me VKM nr. 1323, date 1.10.2008 *“Për kalimin në pronësi, nga armo sha-ja, Tiranë, Bashkisë Kuçovë, të ish-uzinës së përpunimit të naftës, Kuçovë, dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 208, date 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.”*, në kundërshtim me kreun IV, nenet 13 e 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001.

4.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të marrë masat e nevojshme, për regjistrimin në ZVRPP Kuçovë të aseteve të cilat i kanë kaluar në pronësi ose përdorim me VKM nr. 662, date 8.10.2004, i ndryshuar me VKM nr. 1323, date 1.10.2008 dhe për një ndryshim në vendimin nr. 208, date 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.”*.

Menjëherë

5 Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka ngritur zyra për administrimin dhe mbrojtjen e tokës (ZAMT), veprime këto në kundërshtim me: kreu II nenin 6, kreu III nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 *“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”*, kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës, si funksion i tyre sipas përcaktimit në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”* i ndryshuar.

5.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa dhe të nxjerr aktin administrativ për krijimin dhe funksionimin e zyrës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës (ZAMT), duke përcaktuar dhe detyrat funksionale në rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka kryer inventarizimin fizik dhe kontabël dhe nuk i ka përfshirë sipas vlerës së tyre në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël në zërin “Toka, troje, terrene, etj.”, pasi në asnjë bilanc të periudhës objekt auditimi, kjo vlerë jo vetëm që nuk pasqyrohet në rreshtin 10, llogaria 210, por gjithashtu nuk pasqyrohet as në bilancin e fondit të tokës me strukturën ligjore përkatëse në mënyrë ekstra kontabël, në kundërshtim me Neni 7, pikat 1,2, Kreun II, neni 12, neni 18, pika 1 Kreu III, të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar .

6.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të marrë masa, për kryerjen e inventarizimit fizik dhe përfshirjen e vlerës, në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël i zërit: “Toka, troje, terrene, objekte, etj.”, në rreshtat dhe llogaritë përkatëse të bilancin.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Dhënia e 78 objekteve/banesa me qera, me kontrata 1 vjeçare, pasuri të cilat nuk janë të regjistruar më parë në ZVRPP, në këto kushte dhënia e objekteve me qera, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është i përcaktuar në nenin 678 të **Kodit Civil**, “*Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*”, pronat objekt i këtyre kontratave edhe pse janë në listën e pronave të transferuara me VKM, nuk janë në pronësi të Bashkisë Kuçovë dhe nuk posedohen dokumente pronësie.

7.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika “c” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Për Kodin e Procedurës Administrative*”, për deklarimin të pavlefshëm të 78 kontrata për dhënie e objekteve/banesave me qera, si kontrata të hartuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë disponon troje, ndërtesa dhe objekte në pronësi të saj, por me pretendime për pronësi nga persona të tretë ose të zaptuara dhe jashtë funksionit dhe që nuk janë vënë në efikasitet, ose përdoren në mënyrë të paligjshme nga persona të tretë, duke sjellë të ardhura të munguara për bashkinë në vlerën **7.684.626 lekë**. Veprime këto në kundërshtim me Kreu III, pika 1 germa a, paragrafi 4-5 të VKM nr.529, datë 8.6.2011 i ndryshuar, Kreun III, pika 1, germat a, VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

8.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të bëjë inventarizimin, identifikimin e gjendjes fizike e juridike, të marrë nën administrim dhe të kërkojë në rrugë ligjore të ardhurat nga përdorimi i paligjshëm dhe zaptimi i pasurive nga persona të tretë dhe ato jashtë funksionit të pasurive të llojit troje, ndërtesa, objekte në pronësi të Bashkisë, transferuar me VKM nr. 662, date 8.10.2004 “*Për miratimin e listës përfundimtarë të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë së Kuçovës*”, ndryshuar me VKM nr. 1323, date 1.10.2008 “*Për kalimin në pronësi, nga armo sh.a., Tiranë, Bashkisë Kuçovë, të ish-uzinës së përpunimit të naftës, Kuçovë, dhe për një ndryshim në Vendimin nr.208, date 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të*

cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.", të përfundojë procesin e regjistrimit në ZVRPP Kuçovë, të njoftojë personat të cilët kanë kryer zënien apo posedimin në mënyrë të kundërligjshme, për kërkimin dhe zhdëmtimin e dëmeve, si të ardhurave të munguara nga zaptimi i paligjshëm i tyre, sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Korrik 2015

9. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e lidhur me subjektin "E...I" shpk më datë 28.10.2011, nr. 1578 rep, nr 7273 kol, rezulton se pasuria numër 13/24 me sipërfaqe 1507 m², nuk ka dokument pronësie me të cilin të vërtetohet se Bashkia Kuçovë është pronare e këtij trualli, pra sendi objekt qiraje nuk ekziston në natyrë, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është i përcaktuar në nenin 678 të **Kodit Civil**, "*Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*".

9.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika "c" të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "*Për Kodin e Procedurës Administrative*", për deklarimin të pavlefshëm të kontratës nr. 1578 rep, nr 7273 kol datë 28.10.2011 lidhur midis Bashkisë Kuçovë dhe subjektit E...I"

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka hartuar një plan për lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjike, në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, në një periudhë afatmesme 3 vjeçare.

10.1 Rekomandim: Të hartohet plani për përcaktimin e prioritetëve strategjike në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, ku programet e shpenzimeve të planifikohen edhe në periudha 3 vjeçare.

Në vazhdim

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës, në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.2.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit në vlerën **2,018,200 lekë**. Pavarësisht ndjekjes në rrugë ligjore dhe konstatimeve, nga ana e NJQV të vendimeve të gjykatës për dëmshpërblimet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përgjegjësia është e institucionit, i cili nuk ka analizuar të gjitha vendimet, që kanë sjellë dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë administrative për shkaktarët.

11.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë përgjegjësitë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me Institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pa mbështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore duke paguar shumën **2,018,200 lekë**.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë nuk ka evidentuar dhe ndjekur të ardhurat e krijuara nga çerdhet dhe kopshtet, me arkëtimet e kryera në arkë, për çdo person sipas listë prezencave të fëmijëve. Veprime këto në kundërshtim me

paragrafin III pika 35 germa a, b, c. pika 37, 38 e 39 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, neni 42, 43 dhe 44, germa a, pika 47, 48 e 50 “Transporti i aktiveve” pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve”, pika 37, të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”. Detyrime debitore për çerdhet për 130 persona në vlerë **613,780 lekë**, nga e cila: Detyrime për vitin 2013 që i përkatësin 28 persona në vlerë 77,610 lekë, dhe në vitin 2014 për 102 persona në vlerë 536,170 lekë. Detyrime debitore të kopshteve për vitin 2013 janë 285 persona në vlerë **808,050 lekë** dhe për vitin 2014 janë 324 persona në vlerë **1,379,360 lekë**. Por nga verifikimi dhe ballafaqimi rezulton se dokumentacioni i paraqitur (mandat arkëtimet) që disponojnë personat nuk janë paraqitur dhe rregjistruar pranë zyrës së financës në vlerën **87,525 lekë për të cilën duhej ngarkuar ish arkëtari A.P**

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Finance-Buxhetit të saktësojë dhe të evidentojë detyrimet e pa arkëtuara nga çerdhe dhe kopshte për çdo person, në bazë të dokumentacionit që disponojnë (Mandat Arkëtimi), të kontabilizohen dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **2,801,190 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbartimore.

Brenda datës 30.05.2015

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë (Drejtoria Financës dhe Buxhetit), nuk ka zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitore, sipas bilancit kontabël të mbartura nga vitet e mëparshme gjendje në fillim të vitit 2013 në vlerë **30,433,361 lekë**, pasi nuk i ka të analizuara me persona apo subjekte dhe nuk disponojnë dokumentacionin ligjore, për krijimin e detyrimeve debitorenë vite, llojin dhe shumën e detyrimit .

13.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë (Drejtoria Financës dhe Buxhetit) të marrë masa, për të saktësuar me dokumentacionin ligjore detyrimet debitorë të mbartura, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbartimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **30,433,361 lekë**.

Brenda datës 30.09.2015

14. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk ka grumbulluar dhe arkëuar detyrimet tatimore nga 83 subjekte **në shumën 5,130,025 lekë, të ndara:**

- 58 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,893,063 lekë.
- 2 subjekte të biznesit të madh në vlerën prej 239,612 lekë.
- 4 subjekte të ndërmarrjeve /institucioneve me vlerën 2,595,593 lekë.
- 9 subjekte për zënien e hapësirave publike në vlerën 230,262 lekë.
- 13 subjekte për vendosje reklama publike në vlerën 171,495 lekë. Veprime këto në kundërshtim me nenin 5, germa “ç“, nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë”, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Kuçovë nr.20, datë 26.03.2013, neni 35, “Detyrat e Drejtorisë së të Ardhurave lokale”.

14.1.Rekomandim: Bashkia Kuçovë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa, për zbatimin e procedurave ligjore për vjeljen e detyrimeve tatimore nga **83 subjekte në shumën 5,130,025 lekë**, për:

- 58 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,893,063 lekë,
- 2 subjekte të biznesit të madh në vlerën prej 239,612 lekë,
- 4 subjekte të ndërmarrjeve /institucioneve me vlerën 2,595,593 lekë,
- 9 subjekte për zënien e hapësirave publike në vlerën 230,262 lekë,
- 13 subjekte për vendosje reklama publicitare në vlerën 171,495 lekë,

Brenda muajit Shtator 2015

15. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2013 dhe 2014, nuk ka rregjistruar 46 subjekte në QKR, të cilat vazhdojnë aktivitetin e tyre rregullisht.

15.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, për të rregjistruar 46 subjekte në QKR, të cilat rezultojnë të pa regjistruara , duke zbatuar penalitetet tatimore, sipas dispozitave ligjore në fuqi nga gjobë në bllokim e sekuestrim aktiviteti.

Brenda muajit Shtator 2015

16. Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka bashkëpunuar dhe kërkuar Këshillit Bashkiak Kuçovë, ndërhyrjen me forcë të Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore

16.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ti kërkohej Këshillit Bashkiak Kuçovë ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Menjëherë

17. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Kuçovë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në asnjë rast, nuk ka lidhur kontrata me shoqëritë apo subjektet private për dhënien për përdorim të hapësirave publike(publicitare), por është lënë në dorë të spontanitetit, duke mos i administruar e përdorur në mënyrë eficiente për të rritur tëardhurat e bashkisë.

17.1.Rekomandim: Bashkia Kuçovë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, për të gjitha reklamata publicitare, që gjenden në territorin e Bashkisë, të lidhen kontrata me shoqëritë, apo subjektet private për dhënien për përdorim të hapësirave publike sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

18. Gjetjet nga auditimi: Policia Bashkiake nuk ka bërë përpjekje për arkëtimin e 70 gjobave në **vlerën 56,500 lekë**, në zbatim me neni 14 pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

18.1. Rekomandim: Policia Bashkiake të fillojë menjëherë të gjitha përpjekjet për arkëtimin e 79 gjobave në **vlerën 62,,500 lekë**, në zbatim me neni 14 pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Brenda muajit Maj 2015

19. Gjetjet nga auditimi: Nuk janë administruar dhe dokumentuar fletët e udhëtimit të mjetit “Skrep” në Ndërmarrjen Komunale Kuçovë, të cilat janë të

firmosur vetëm nga manovratori. Të gjitha shërbimet ose punimet janë paraqitur në orë pune, në asnjë rast nuk kemi volum pune të kryer nga ky mjet. Preventivat dhe situacionet janë hartuar për gjithë aktivitetin e ndërmarrjes komunale dhe jo se ku ka punuar skrepi, sa volum pune ka kryer dhe sa orë pune. Në asnjë rast nuk ka bashkëlidhur asnjë urdhër pune për shërbimin që do të kryej ky mjet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me paragrafin III pika 35 germa a, b, c. pika 37, 38 e 39. Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara neni 42, 43 dhe 44 germa a, pika 47, 48 e 50. Transporti i aktiveve pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve pika 37, të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”.

19.1. Rekomandim: Ndërmarrja Komunale Kuçovë të marrë masa, që në vijim fletët e udhëtimit për të gjitha mjetet që disponon kjo ndërmarrje të firmosen nga drejtuesi që mbulon këtë aktivitet. Të gjitha shërbimet ose punimet të raportohen me volum pune duke i shoqëruar me preventiv dhe situacion.

Vazhdimisht

20. Gjetjet nga auditimi: Bashkia Kuçovë, nuk ka zbatuar 3, masa organizative të kërkuara nga KLSH-ja, duke mos arkëtuar nga subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh detyrimin e taksave në shumën **4,365,532 lekë**.

Nuk ka zbatuar Masat për shpërblim dëmi, duke mos ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit me vlerën **5,117,398 lekë**, nga të cilat vlera 2,766,633 lekë në fushën e prokurimeve dhe zbatimin e kontratave për punë publike, vlera 1,138,918 lekë në fushën e administrimit material e financiar, dhe vlera 1,211,845 lekë në fushën e urbanistikës. Në kundërshtim me, nenet 90 dhe 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

20.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës nga subjektet e biznesit të vogël dhe të madh, detyrimin e taksave të pa paguara në vlerën **4,365,532 lekë dhe shpërblim dëmi, në shumën 5,117,398 lekë**, nga të cilat vlera 2,766,633 lekë në fushën e prokurimeve dhe zbatimin e kontratave për punë publike, vlera 1,138,918 lekë në fushën e administrimit material e financiar, dhe vlera 1,211,845 lekë në fushën e urbanistikës. të rekomanduara nga auditimi i mëparshëm i KLSH.

Brenda muajit Shtator 2015

21. Gjetje nga auditimi: Për objektin “Rikonstruksioni i Rrugës Naftëtari, Lagja nr. 1 Blloku Tafil Skëndo” me vlerë të plotë të preventuar 104,799,041 lekë pa T.V.SH nuk është bërë opoenca teknike e preventivit të projektit në kundërshtim me ligjin nr., 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 6.

21.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të marrë masa, që në projektet e ardhshme të kryhet opoenca teknike e projektit për projektet me vlerë të preventuar mbi 100,000,000 lekë, kjo në përputhje me ligjin nr., 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 6.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e dëmit të shkaktuar njësisë publike në **vlerën 24.966.132 lekë**.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për shpërblimin e fundvitit për 72 persona në vlerë totale prej **259.200 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 849, datë 6.12.2012 *Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë"*, të ndryshuar.

1.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **259.200 lekë**, për 72 persona sipas pasqyrës “a-b-c”.

Brenda muajit Qershor 2015

2. Gjetje nga auditimi: Është emëruar znj. Kristina Zoga në pozicionin e vendit të punës “Specialiste në Sektorin e Kordinim Zhvillimit”, pa u bërë njohja dhe konvertimi i diplomës së saj, duke përfituar padrejtësisht pagë si specialiste me arsim të Lartë në vlerën **336,000 lekë**, veprim ky në kundërshtim me nenin 37 pika 1, të Ligjit Nr 9741, datë 21.5.2007 *“Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

2.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore, për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **336,000 lekë** nga znj. K.Z.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë ka dhënë me qira me kontrate objekte/troje, në 3 raste, për të cilat nuk është përlllogaritur saktë vlera e qerasë dhe si e tillë nuk është arkëtuar detyrimi në vlerën **2,713,878 lekë**. Veprime këto në kundërshtim me pika 1 gërma a, b, c, Kreu III të VKM nr.529, datë 8.6.2011, i ndryshuar, pikën 1, gërmat a, b, pikën 2 Kreun III e VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

3.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **2,713,878 lekë**, sipas pasqyrës “a” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Qershor 2015

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë në kontratat e lidhura për banesat nuk ka përlllogaritur saktë vlerën e qerasë duke përdorur referencë të gabuar ligjore, si rezultat nuk është derdhur detyrimi në vlerën **9.416.991 lekë**, në kundërshtim me pika 1 germa a, paragrafi 4-5, Kreu III të VKM nr.529, datë 8.6.2011, i ndryshuar, Kreun III, pika 1, gërmat a, VKM nr. 54, datë 5.2.2014.

4.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e

grykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **9.416.991 lekë** sipas aneksin nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shtator 2015

5. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik për 6 subjektet të cilëve u ka aplikuar gjobë, nuk ka përllogaritur 2 % kamatë vonesë në ditë në vlerën **1.260.000 lekë**, në kundërshtim me kreun IV “Saksionet”, neni 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 .

5.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e grykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **1.260.000 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2015

6. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me pikën 9,14 dhe 15 të VKM nr.864 datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”, është paguar z. B.GJ, me detyrë kryetar i Bashkisë, shpenzime për telefon celularë, për vitin 2013 në 7 raste në vlerë **77,581 lekë**, dhe vitin 2014 në 5 raste në vlerë **48,000 lekë** .

6.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e grykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **125,581 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2015

7. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nuk është nxjerrë përgjegjësia materiale për karburantin e shpenzuar sipas fletë udhëtimeve për itinerarin e lëvizjes dhe km të përshkruara, krahasuar me km e miratuar sipas tabelës kilometrike për mjetin Toyota KV2867B me drejtues mjeti z. B.Z, gjithsej 4762 km, në vlerë **124,895 lekë** (714,3 litra x 174,85).

7.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e grykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **124,895 lekë nga B.Z.**

Brenda muajit Qershor 2015

8. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dalë në zbatim të ligjit, nuk është nxjerrë përgjegjësia materiale për karburantin e shpenzuar sipas fletë udhëtimeve për intenerarin e lëvizjes dhe km të përshkruara, krahasuar me km e miratuar sipas tabelës kilometrike për mjetin Benz Sel 560 me drejtues mjeti, gjithsej 1750 km, në vlerë **36,718,50 lekë** (210 litra x 174,85) z. XH.H.

8.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e grykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **36,718 lekë** nga z. XH.H.

Brenda muajit Qershor 2015.

9.Gjetjet nga auditivi: Është konstatuar se nga ana e magazinierit të ndërmarrjes Komunale Kuçovë, janë prerë 3 fletë dalje për 270 litra gazoil në vlerën **50,479 lekë**. Fletë daljet nuk janë të firmosura nga magazinieri si dhe nga marrësi, dhe urdhër dorëzimi nuk është i firmosur nga marrësi, sasia e karburantit të bërë dalje

sipas fletë daljeve është e pa justifikuar dhe përbën dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga magazinieri. Veprim ky në kundërshtim me paragrafin III, pika 35, germa a, b, c, pika 37, 38 e 39 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” neni 42, 43 dhe 44 germa a, pika 47, 48 e 50 “Transporti i aktiveve” pika 51 dhe Kap. IV “Inventarizimi i aktiveve pika 37, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9.1. Rekomandim: Ndërmarrjen Komunale Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, shpërblimin e dëmit në vlerën **50,479 lekë** nga magazinieri A.H, për dalje të karburantit me dokumentacion jo të rregullt.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi. Nuk janë dokumentuar përdorimi i karburantit për vitin 2014 nga z.P.D, në sasinë 45 litra Gazoil për mjetin Rul, ku rezulton diferencë e pa justifikuar me fletët e udhëtimit, për 30 litra në vlerën **5,460 lekë**, në kundërshtim me paragrafin III, pika 35, germa a, b, c. pika 37, 38 e 39 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, neni 42, 43 dhe 44, germa a, pika 47, 48 e 50 “Transporti i aktiveve”, pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve”, pika 37, e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

10.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, shpërblimin e dëmit në vlerën **5,460 lekë**, për diferencë të pa justifikuar nga z. P.D.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Kaldaja e “ Kopshtit dhe Çerdhes nr. 5”, për vitin 2013 dhe 2014, rezulton me diferencë të pa justifikuar me dokumente për sasinë 827 litra Gazoil në vlerën **151,341 lekë**. Veprime në kundërshtim me neni 42 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, neni 43 dhe 44, germa a, pika 47, 48 e 50 “Transporti i aktiveve” pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve” pika 37 e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

11.1. Rekomandim: Shpërblimi i dëmit në **vlerën 151,341 lekë**, për diferencë të pa justifikuar të 827 litra Gazoil nga këta persona, përkatësisht: E.D vlera 37,835 lekë, F.Ç vlera 37,835 lekë, A.Ziu vlera 37,835 lekë dhe M.H vlera 37,835 lekë.

Brenda muajit Qershor 2015

12. Gjetjet nga auditimi, në Bashkinë Kuçovë për vitin 2013 dhe 2014, janë Rikonstruktuar rrugët nga “Kryqëzimi në hyrje të tregu i Ri”, sipas shtesës së kontratës nr.—datë 02.06.2013, .Sipërfaqja është 5000 m2 dhe për rrugën nga “Kryqëzimi në hyrje – Sheshi i pazarit- Hyrja e Teknikumit”, sipas kontratës datë 13.08.2014, për sipërfaqen 4700 m2, firma “H...a” sh.p.k, ka përfutur padrejtësisht nëpërmjet situacionit pa kryer shërbimin e pastrimit me fshesë dhe larjen e rrugëve për të dy segmentet në shumën shumë **159,985 lekë**. Veprim ky në kundërshtim me germa b dhe c, të pikës 2.4, neni 25, “Rregulla për tu zbatuar”, sipas të cilës, citojmë: “.....nuk do të lejohen rrugë të pa pastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktor të jashtëm të cilët nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në

metodologji kontraktuese duhet të njoftohet menjëherë e të merren masa për pastrimin e tyre.....“.

12.1. Rekomandim: Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **159,985 lekë**, nga firma e pastrimit “H....a” shpk., për shërbim të pa kryer.

Brenda muajit Maj 20015

13. Gjetjet nga auditimi, në Bashkinë Kuçovë për vitin 2014 nga ana e Firmës “H...a” shpk, janë raportuar shërbime për ” Zërin fshirje rrugëve me mjet teknologji” për 23 ditë, në vlerën **158,316 lekë**. Sipas situacioneve të mësipërme rezulton se nga firma “H...a, nuk ka kryer shërbimin për muajin Janar, Shkurt, Dhjetor 2013 dhe për muajin Mars 2014 vetëm 3 ditë.

13.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **158,316 lekë**, nga firma e pastrimit “H...a” shpk., për shërbim të pa kryer.

Menjëherë

14.. Gjetjet nga auditimi, Është përgatitur e miratuar projekt – preventivi dhe zbatuar për objektin “*Rikonstruksioni i Rrugës Naftëtari, Lagja nr. 1 Blloku Tafil Skëndo*”, jo në përputhje me projektin, me një diferencë më tepër në vlerën **9,847,488 lekë pa T.V.SH**, duke sjellë si pasojë përfitimin padrejtësisht të subjektit fitues të kësaj vlere, në dëm të buxhetit të shtetit. Ky projekt preventiv i zbatuar është përgatitur nga z. Gj.C në cilësinë e Drejtorit të Urbanistikës, z. J.L dhe z. E.M në cilësinë e hartuesit dhe preventivuesit të projektit, të cilët kanë sjellë si pasojë përfitimin e padrejtë të vlerës prej **9,847,488 lekë pa T.V.SH** nga operatori ekonomik fitues **B....A shpk**.

14.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 9,847,488 lekë, përkatësisht: z.Gj.C. vlerën **2,461,872 lekë**, z. J.L vlerën **32,461,872 lekë** dhe z. E.M vlerën **2,461,872 lekë**, si dhe **operatori ekonomik B...A shpk** në vlerën **2,461,872 lekë**, e cila ka përfituar këto vlere për miratim të projekt – preventivit, jo në përputhje me projektin e zbatimit me dëm ekonomik buxhetit të shtetit.

Brenda muajit Dhjetor 2015

15. Gjetjet nga auditimi, vlere **295,000 lekë** për firmat “B...a” sh.p.k dhe “S....i” sh.p.k, nën cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr.1133 prot., datë 13.08.2014 me objekt “*Rikonstruksioni i Rrugës Naftëtari, Lagja nr. 1 Blloku Tafil Skëndo*” Kuçovë, për punime të pakryera .

15.1. Rekomandim Bashkia Kuçovë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin të vlerës **295,000 lekë**, nga firmat “B...a” sh.p.k dhe “S....i” sh.p.k, nën cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 1133 prot., datë 13.08.2014, me objekt “*Rikonstruksioni i Rrugës Naftëtari, Lagja nr. 1 Blloku Tafil Skëndo*” Kuçovë, për punime të pakryera.

Brenda muajit Qershor 2015

C. MASA DISIPLINORE

-Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, rekomandojmë që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore

C/I. Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, nga “Vërejtje” deri “Largim nga detyra” dhe për punonjësit me kontratë “Zgjidhje e kontratës së së punës”, për punonjësit e më poshtëm:

1. A.P, me detyrë ish arkëtar, kaluar pranë Drejtorisë Qendërse Ekonomike të Arsimit.

Nga ana e arkëtarit janë përvetësuar vlera 87,525 lekë, e konstatuar nga verifikimi dhe ballafaqimi me disa nga prindërit e fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve(të cilët paraqitën pran grupit të auditimit, dokumentacionin (mandat arkëtimet)të lëshuara nga arkëtari A.P), që rezultojnë me detyrimet debitoare të pa arkëtuara për vitin 2014. Kjo vlerë nuk është arkëtuar por është përvetësuar(për këtë Prokuroria e Rrethit Berat, ka filluar procedimin penal ndaj këtij personi).

Nga auditimi i dokumentacionit të debitorëve për çerdhet dhe kopshtet, me arkëtimet e kryera në arkë për çdo person sipas listë prezencave të fëmijëve. Që rezultojnë debitorë për vitin 2014, paraqiten:

- Çerdhet për 130 persona në vlerë 613,780 lekë,

- Kopshtet për 324 persona në vlerë 1,379,360 lekë.

Nuk është bërë mbyllja e veprimeve me arkën, por janë kryer veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit për diferencat në mungesë, për dy inventarët e kryer brenda muajit Dhjetor 2014. Në inventarin e datës 24.12.2014 mbajtur nga znj. H.SH me detyrë Drejtore e Financës dhe Buxhetit me përgjegjësin material z. A.P, ka rezultuar me diferencë në mungesë në vlerë **68,200 lekë**. Është bërë arkëtimi me faturën nr. 121 datë 31.12.2014 nga znj. H.SH në shumën 68,200 lekë , në emër të arkëtarit z. A.P me përshkrimin e të ardhurave nga kopshte.

- Janë regjistruar në librin e arkës pagesat me përshkrimin H.SH derdhje në bankë, pa prerë mandat pagesë. Gjithashtu me proces verbalin e datës 31.12.2014 arka me përgjegjës material z. A.P ka rezultuar me diferencë në mungesë **10,910 lekë**.

2. Për znj. H.SH me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit, “Për prokurimet me vlera të vogla”,

-Nuk ka bërë mbyllja e veprimeve me arkën, ka lejuar kryerjen e veprimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit, për diferencat në mungesë në dy inventarët e kryer brenda muajit Dhjetor 2014. Veprimet dhe mosveprimet e kryera janë në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- për të meta dhe mangësi në mbajtjen e dokumentacionit dhe inventarit të arkës, në evidentimin dhe ndjekjen e detyrimeve për çerdhe dhe kopshte, sipas listë prezencës të numrit të fëmijëve me arkëtimet e kryera në arkë për çdo person, në kundërshtim me paragrafin III, pika 35 germa a, b, c. pika 37, 38 e 39, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, neni 42, 43 dhe 44, germa a, pika 47, 48 e 50 “Transporti i aktiveve” pika 51 dhe Kapitulli i IV “*Inventarizimi i aktiveve*” pika 37 e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik*”.

- për të meta dhe mangësi për pagesa të kryera me vendime gjykate me urdhër vendosje sekuestro konservative nga Përmbaruesi Gjyqësor, për ekzekutim të titullit ekzekutiv detyrime nga mardhëniet e punës, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë i ndryshuar nenin 153 dhe 154, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, nuk janë analizuar vendimet për dëmin efektiv të krijuar për buxhetin e shtetit dhe nuk është kërkuar nxjerrja e përgjegjësisë ndaj shkaktarëve.

- për të meta dhe mangësi, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë, për shpenzime të programuara dhe të pa realizuara, ose të kryera në fakt dhe të pa financuara për mungesë fondesh, nga mos realizimi i të ardhurave faktike,

- për shpenzime operative dhe investime, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dalë në zbatim të ligjit “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

- për të meta dhe mangësi për pagesa të kryera për shpenzime telefoni celularë, në kundërshtim me pikën 9,14 dhe 15 të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “*Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik*”.

- për të meta dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dokumentimin dhe ndjekjen e detyrimeve debitorë të trashëguara nga vitet e mëparshme në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin*”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, VKM nr. 248 datë 10.04.1998, të ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “*Për miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njërive që varen prej tyre*” dhe udhëzimit të MF nr. 14, datë 28.12.2006 ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 “*Për përgatitjen dhe mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2011*”.

- për të meta dhe mangësi në procedurat e Prokurimit Publik, konkretisht “Blerje me vlera të vogla”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar, kreu i I, pika 1 germa b, pika 3, germa a dhe d, Kreu II, pika 1 dhe Kreu III, pika 3, germa b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- për të meta dhe mangësi në procedurat e Prokurimit Publik, në prokurimet e kryera për 7 tendera të cituara më hollësisht më poshtë në Germa C/ e këtij Vendimi.

3. A. D, me detyrë Drejtor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor.

-Për periudhën 2 vjeçare, ka vendosur 6 gjoba në vlerën 2.1 milion lekë, të cilat nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë arkëtuar. Për 6 raste gjobash, **në vlerën 2.100.000 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguar**, nuk janë arkëtuar detyrimet dhe nuk janë zbatuar procedurat ligjore për vjeljen e tyre. Gjithashtu për 6 subjektet ndaj të cilëve është aplikuar gjobë dhe nuk është kryer pagesa e saj brenda afatit ligjor, nga ana e kryeinspektorit dhe personit të cilit i ngarkohet detyra për përlogaritjen e kamatëvonesës 2% për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, veprime këto në kundërshtim me kreun IV sanksionet neni 16 ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 i ndryshuar. Nisur nga përlogaritja e kamatë vonesës si në pasqyrën Nr.1, rezulton diferenca në vlerën **1.260.000 lekë**, shumë e cila përbën dëm ekonomik.

3. G.Q, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në cilësinë e anëtarit të Njesisë prokurimit në të 7 tenderët e paraqitura me shkelje e mangësi ligjore.

4. K. M, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës të Financës pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit në cilësinë në cilësinë e anëtarit të Njesisë prokurimit në të 6 tenderët e paraqitura me shkelje e mangësi ligjore, të zhvilluara në vitin 2013.

5. A. C, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes Komunale, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, për tenderin e zhvilluar në vitin 2014

6. O. Z, me detyrë specialist në Zyrën e Urbanistikës me cilësinë e në cilësinë e anëtarit të Njesisë prokurimit për tenderin e zhvilluar në vitin 2014, me shkelje e mangësi ligjore.

7. SH. N, me detyrë N/Kryetar i Bashkisë në cilësinë e kryetarit të KVO-së në të gjithë tenderët e zhvilluara në vitin 2013 dhe 2014 me mangësi e shkelje ligjore, si më poshtë:

1. Tenderi me objekt: “Blerje makine me kosh hidraulik për vitin 2013

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreun 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

-Dokumentet Standarde të Tenderit, (DST) nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreun 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreun V, pika 4, germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësim/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditor i paraqitjes së ankesave, (afat ky brenda të cilit edhe sistemi elektronik rezulton i pa aksesueshëm për të proceduar), për t’ia paraqitur më pas raportin përfundimtar mbi procedurën,

- Mungon formulari i njoftimit të fituesit i botuar në buletin, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar si dokument dhe i botuar në buletin.

2. Tenderi me objekt: “Blerje materialeve për mirëmbajtjen ndërtesave në ndërmarrjen Komunale”.

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreun 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

- Dokumentet Standarde të Tenderit, (DST) nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave , në kundërshtim me kreu V, pika 4, germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditor i paraqitjes së ankesave, (afat ky brenda të cilit edhe sistemi elektronik rezulton i pa aksesueshëm për të proceduar)

- Mungon formulari i njoftimit të fituesit i botuar në buletin, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar si dokument dhe i botuar në buletin.

3. Tenderi me objekt: “Blerje materialesh elektrike për ndriçimin publik për vitin 2013”

Operatori ekonomik “Vaskë Gaqi” rezulton i pavlerësuar nga KVO-ja, pavarësisht se ky operator nuk i ka paraqitur të gjitha dokumentet vërtetues për të përmbushur kriteret pjesëmarrëse të caktuara, oferta e tij duhej të vlerësohej nga KVO-ja dhe me pas të s’kualifikohej.

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

-Dokumentet Standarde të Tenderit, (DST) nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreu V, pika 4 , germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor para afatit ligjor, pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditor i paraqitjes së ankesave,.

-Mungon njoftimi i kontratës së nënshkruar i botuar në buletin.

4. Tenderi me objekt “Blerje ushqimesh dhe materiale pastrimi për Q.E.A Kuçovë”

-Konkretisht: Vlerësimi i ofertës së vetme pjesëmarrëse nga KVO-ja është mbyllur me datë 22.05.2013, sipas të cilit të tre anëtarët e KVO-së kanë gabuar në vlerën e ofertës së operatorit fitues çka do të thotë që në formularin e ofertës së tij, ofertuesi për mallrat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, ka ofertuar në një vlerë prej 2.377.800 lekë pa TVSh dhe 2.853.360 lekë me TVSh, dhe kjo duhet të ishte vlera e kontratës me këtë fitues.

-Komisioni ka shënuar në sistem në fazën e njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës, vlerën e ofertës 2.336.000 lekë pa TVSh, kurse në formularin e njoftimit të fituesit është shënuar vlera e ofertës fituese 1.105.950 lekë pa TVSh, ndërkohë që në formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar ngarkuar në sistem, është shënuar vlera 2.336.000 lekë pa TVSh , si vlerë të ofertës fituese.

- Nuk janë zbatuar afatet ligjore dhe kjo procedurë duhej të anulohet pasi data e lidhjes së kontratës është shënuar me 29.05.2013, në një kohë kur nuk mund të

nënshkruhej kontrata në këtë datë, pasi më datë 29.05.2013 sistemi ka qenë i aksesueshëm për të ngarkuar formularin e njoftimit të fituesit. Ndërkohë që për njoftimin e kontratës së nënshkruar sistemi ka qenë i aksesueshëm nga data 30.05.2013 – 30.06.2013, brenda këtij muaji palët kanë pasur të drejtë të nënshkruajnë kontratën, nëse operatori do të tërhiqej pas përfundimit të këtij afati, atëherë Autoriteti Kontraktor, duhet t'i konfiskonte sigurimin e ofertës dhe të anulonte këtë procedurë prokurimi, duke qenë se nuk kishte operator të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, në mënyrë që kontrata t'i akordohej atij.

-Ndërkohë njoftimi i fituesit rezulton të jetë botuar në buletin nr. 4 datë 24.01.2014 fq. 77-78, në një kohë kur në zbatim të përpiktë të afateve ligjore njoftimi i fituesit duhej të ngarkohej më datë 29.05.2013 për t'u botuar me datë 03.06.2013.

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

-Dokumentet Standarde të Tenderit, (DST) nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreu V, pika 4, germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditë i paraqitjes së ankesave-Mungon formulari i njoftimit të fituesit i botuar në buletin dhe formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar i botuar në buletin.

5. Tenderi me objekt: *“Blerje mish viçi dhe fruta – perime për Q.E.A Kuçovë”*

-Parregullsi në mbylljen e fazave “Njoftim i lidhjes së kontratës” dhe “arkivimi i kontratës”, të cilat janë mbyllur në mars të vitit 2014 në një kohë kur duhej të mbylleshin në maj të vitit 2013.

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr.1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

-Dokumentet Standarde të Tenderit(DST), nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreu V, pika 4, germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditë i paraqitjes së ankesave.

-Mungon formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar i botuar në buletin.

6. Tenderi me objekt *“Blerje materiale ndërtimi për ndërmarrjen Komunale Kuçovë”*

Mangësitë ligjore dhe procedurale:

Kjo procedurë prokurimi nuk figuron të jetë publikuar në mënyrë elektronike, në serverin e publikimeve të prokurimit, veprim në kundërshtim me, pikën 1 të VKM nr. 45, datë 21.01.2009, “Për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronike “

-Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, **nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse** në këtë procedurë prokurimi.

-Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreu V, pika 4, germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor pra në të njëjtën datë kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati 7 (shtatë) ditor i paraqitjes së ankesave,.

-Dokumentet “*Formular i njoftimit të fituesit*” dhe “*Formular i kontratës*” rezultojnë të parregullta, pa datë, duke bërë kështu të pa evidentueshëm afati e fillimit të fuqisë ligjore të kontratës, për të evidentuar nëse kjo kontratë është zbatuar brenda afatit të vendosur për ekzekutimin e saj ose jo.

7. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i KUZ Lagja “11 Janari” Kuçovë”.për vitin 2014.

1. Në këtë procedurë prokurimi *mungojnë specifikimet teknike*, në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar (ligji nr. 131/2012). Preventivuesi nuk ka përgatitur specifikimet teknike në mënyrë që të përcaktoheshin qartë karakteristikat e punëve që do të kryhen, për operatorët ekonomik të interesuar.

Njësia e prokurimit nuk ka ngarkuar elektronikisht specifikime teknike të punëve përkatëse, por vetëm preventivin dhe projektin përkatës.

2. Njësia e prokurimit, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi II, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, **nuk ka argumentuar kriteret pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.**

3. Dokumentet Standarde të Tenderit, (DST) *nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit*, në kundërshtim me kreu 5, pika 2, germa a, paragrafi III, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”.

4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me kreu V, pika 4 , germa gj, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, ka përgatitur raportin përmbledhës të kësaj procedure dhe ia ka paraqitur titullarit të Autoritetit Kontraktor, para afatit ligjor. Pra në të njëjtën datë, kur ka mbyllur fazën e vlerësimit/klasifikimit të ofertave pjesëmarrëse, konkretisht datë 2.12.2014, në një kohë kur duhej të priste të kalonte afati ligjor prej 7 ditësh i paraqitjes së ankesave, Gjithashtu, dokumenti me objekt “*Miratim*” i nënshkruar nga titullari, nuk është akt administrativ i rregullt pasi nuk ka një datë të caktuar në të cilën titullari miraton raportin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

8. TH.N, me detyrë Drejtor i Drejtorisë të të ardhura ve Vendore

9. S.L, me detyrë Inspektor i biznesit të vogël.

10. L. Z, me detyrë Inspektor i biznesit të vogël

11. D.S, me detyrë Inspektore e biznesit të vogël

Nuk kanë bërë përpjekje për realizimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat vendore:

-Për vitin 2013, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 87,727,000 lekë të parashikuara janë realizuar 65,931,000 lekë, ose 21,796,000 lekë më pak në masën 75 %, si:

- taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,796,000 lekë, taksën e biznesit të vogël për vlerën 3,687,000 lekë, taksa e zënies së hapësirës publike (tregu) në vlerën 1,864,000 lekë, tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit në vlerën 6,580,000 lekë, tarifa e parkimit të automjeteve në 882,000 lekë, tarifa nga legalizimet në vlerën 2,796,000 lekë, etj.

Në mosrealizimet e planit të ardhurave lokale për vitin 2013, peshën kryesore e zë mos pagimi i taksave vendore nga popullata, sidomos për shërbimet e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit, e cila për vitin 2013 është realizuar 66 %, taksa e ndikimit në infrastrukturë është realizuar vetëm 8 % si dhe taksa nga legalizimet është realizuar 20 %.

- Për vitin 2014, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore, nga 97,000,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerë 79,680,000 lekë, ose -17,320,000 lekë më pak në masën 82 %,

-taksën e ndërtesës për vlerën 2,662,000 lekë ku nga katër kategoritë e taksa paguesve 1,851,000 lekë në këtë mosrealizim e zë popullata, taksa e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 1,095,000 lekë, tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit në vlerën 2,493,000 lekë, tarifa e parkimit të automjeteve 1,503,000 lekë, tarifa nga legalizimet 3,500,000 lekë, etj.

Në mosrealizimet e planit të të ardhurave për vitin 2014, peshën kryesore e zë tarifa nga legalizimet e cila është 0 %, taksa e ndikimit në infrastrukturë, realizuar 45 %, taksa e ndërtesës nga popullata 33 %, taksa e parkimit të automjeteve 16 % dhe tarifa nga qiratë e pronave publike 13 %.

- Nuk kanë bërë përpjekje, në vitin 2013, që nga 45 subjekte të biznesit të vogël të cilët rezultojnë debitorë në vlerën 1,203,307 lekë nuk kanë shlyer detyrimin 34 subjekte në vlerën 922,723 lekë,

- Për vitin 2014 rezultojnë debitorë 25 subjekte në vlerën 970,460 lekë,

- nuk kanë arkëtuar vlerën debitorë për 680,196 lekë për periudhën 2013-2014 nga një subjekt privat si dhe “Ndërmarrje dhe institucione”.

- nga ana e Drejtorisë së të ardhurave lokale të Bashkisë Kuçovë, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve tatimore në shumën **4,728,268 lekë**, nga 58 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,893,063 lekë, nga 2 subjekte të biznesit të madh me vlerën 239,612 lekë dhe nga 4 subjekte të ndërmarrjeve/institucioneve me vlerën 2,595,593 lekë.

-Janë nxjerrë listat për subjektet debitor për pagesën e detyrimeve dhe i janë dërguar zyrtarisht Policisë Bashkiake dhe Zyrës së Financës dhe është kërkuar ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- Për subjektet debitorë, megjithëse i është kërkuar Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguruese (për mjetet), në zbatim të ligjit nr. 9920,

datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht në nenin 91, nuk janë vazhduar procedurat e mëtejshme në zbatim të ligjit.

-Për subjektet debitorë, megjithëse i është kërkuar ZVRPP Kuçovë vendosja e barrës sigurorese (për pasurinë), në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht në nenin 91, nuk janë vazhduar procedurat e mëtejshme në zbatim të ligjit.

-Nga ana e Drejtorisë të Taksave e Tarifave Vendore për vitin 2013 dhe 2014, nuk janë regjistruar në QKR 46 subjekte të cilët rezultojnë të pa regjistruar dhe vazhdojnë aktivitetin e tyre rregullisht.

- Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nuk i ka kërkuar Këshillit Bashkiak Kuçovë ndërhyrjen me forcë të Policisë Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve nga subjektet debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nën pika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

12. A.H, me detyrë magazinier pran Ndërmarrjes Komunale Kuçovë.

-Nga ana e magazinierit janë prerë fletë daljet nr, 32, datë 02.08.2013, litra 70 x 187.26 = 12,949 lekë, nr, 36, datë 03.9.2013, litra 100 x 187.3 = 18,730 lekë nr, 42, datë 09.11.2013, litra 100 x 187.052 = 18,800 lekë, pra në total 270 litra gazoil në vlerën 50,479 lekë. Për mos administrim të materialeve që kishte në ngarkim dhe për mungesë përgjegjësie materiale e ligjore në detyrën e magazinierit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me paragrafin III, pika 35, germa a, b, c. pika 37, 38 e 39 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, neni 42, 43 dhe 44, germa a, pika 47, 48 e 50. “Transporti i aktiveve”, pika 51 dhe Kapitulli i IV “Inventarizimi i aktiveve”, pika 37, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”.

D. I. MASA ADMINISTRATIVE

D/I. Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” Në bazë të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, , **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **për anëtarët e Komisionit**

Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit, **si më poshtë:**

1. SH.N, në cilësinë e kryetarit të KVO në 6 procedurat e prokurimit:

1. “Blerje makine me kosh hidraulik për vitin 2013
2. “Blerje materialeve për mirëmbajtjen ndërtesave ndërmarrja Komunale.
3. “Blerje materialelesh elektrike për ndriçimin publik për vitin 2013
4. “Blerje ushqimesh dhe materiale pastrimi për Q.E.A Kuçovë”
5. “Blerje mish viçi dhe fruta – perime për Q.E.A Kuçovë”
6. “Blerje materiale ndërtimi për ndërmarrjen Komunale Kuçovë”

2. H.SH, në cilësinë e antarit të KVO në 7 procedurat e prokurimit

3. **J.L** në cilësinë e antarit të KVO në 6 procedurat e prokurimit
4. **G.Q**, në cilësinë e Juristit të NJP në 6 procedurat e prokurimit:
5. **K M**, në cilësinë e antares të NJP, në 6 procedurat e prokurimit:

1. *“Blerje makine me kosh hidraulik për vitin 2013*
2. *“Blerje materialeve për mirëmbajtjen ndërtesave ndërmarrja Komunale.*
- 3.: *“Blerje materialelesh elektrike për ndriçimin publik për vitin 2013*
4. *“Blerje ushqimesh dhe materiale pastrimi për Q.E.A Kuçovë”*
5. *“Blerje mish viçi dhe fruta – perime për Q.E.A Kuçovë”*
6. *“Blerje materiale ndërtimi për ndërmarrjen Komunale Kuçovë”*
7. *“Rikonstruksion I KUZ Lagja “11 Janari” Kuçovë”.për vitin 2014.*
6. **A. C**, , në cilësinë e antarit të Nj. P. për tenderin e zhvilluar në vitin 2014
“Rikonstruksion I KUZ Lagja “11 Janari” Kuçovë”.
7. **O.Z**, në cilësinë e antarit të Nj. P. për tenderin e zhvilluar në vitin 2014
“Rikonstruksion I KUZ Lagja “11 Janari” Kuçovë”.

D.II. Nga Bashkia Kuçovë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Vendor të Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, **të vendosë masë administrative me gjobë sipas shkallës së përgjegjësisë ligjore për:**

1. Bashkimin e operatorëve **“V... I..” sh.p.k** dhe **“I.....ch”**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me pasojë dëm ekonomik, ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **295,000 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

“Rikonstruksioni i Rrugës Naftëtari, Lagja nr. 1 Blloku Tafil Skëndo”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 295,000 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera, veprime në papajftueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

2. **z B.M**, mbikëqyrësi i punimeve për pastrimin e qytetit, për shërbime të pa kryera e përfituara padrejtësisht në vlerën totale **318,301 lekë** nga firma **“Higjiena” sh.p.k** për vitin 2013 dhe 2014, nëpërmjet përgatitjes së situacionit, konkretisht:

-paguar pa kryer shërbimin e pastrimit me fshesë dhe larjen e rrugëve për të dy segmentet në shumën **159,985 lekë**, veprim në kundërshtim me geramat, b dhe c të pikës 2.4 të neni 25, *“Rregulla për tu zbatuar”*,

- janë raportuar shërbime për *“ Zërin fshirje rrugëve me mjet teknologji”* për 23 ditë në **shumën 158,316 lekë**. Sipas situacioneve të mësipërme rezulton se nga firma **“Higjiena”** nuk ka kryer shërbimin për muajin Janar, shkurt, dhjetor dhe për muajin mars vetëm 3 ditë. e cila duhet të kryente këtë shërbim në çdo 4 ditë. Veprim në kundërshtim me pikën 4, 5, dhe 6 të neni 25, 3.4, *“Rregulla për tu zbatuar”*,

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Pirro Imeraj, Dorino Meçe, Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në kontratën individuale të punës, t’i kërkojmë Kryetarit Komunes Paskuqan, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

C/1. “Vërejtje”, germa “a”

1. A.V. me detyrë Përgjegjës i Ujësjiellës Kanalizimeve Paskuqan dhe në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk është mbajtur asnjë dokument si procesverbal, raport përmbledhës për anulimin e procedurës prokurimit në tenderin “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”-“KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, nenin 24, pika 3.

- Nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në procedurat e prokurimit “Projektimi Ujësjiellës Babrru”, “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan” “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9- vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”.

- Nuk është publikuar në sistem njoftimi i lidhjes së kontratës si dhe formulari i njoftimit të fituesit, në tenderin “Projektimi Ujësjiellës Babrru”, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “ç”.

- Përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde të tenderit “Projektimi Ujësjiellës Babrru” dhe “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan” nuk janë të plota, në kundërshtim me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”.

- Nuk është respektuar afati i dorëzimit të dokumenteve për pjesëmarrje në tender në procedurat e prokurimit “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z.

në Paskuqan 2” si dhe “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 43, pika 5.

- Në tenderin Blerje karburanti D1” nuk ka preventiv për përcaktimin e nevojave për karburant për vitin 2013 dhe në tenderin “Blerje materiale inerte” (Çakëll) nuk ka dokument që të tregojë se si është llogaritur çmimi i materialit inert, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut II, pika 2, germa “c” dhe “ç”.

2. F.Ç. me detyrë Përgjegjës i Zyrës Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa “d” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa “a” dhe “c”, pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim, në 3 raste, në procedurat e prokurimit “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, “Sistemi, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër – Kodër e Kuqe Puseta”, “Riparim i rrugës “Demokracia”.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemi, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz”, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B.-I.”sh.p.k & “B...”sh.p.k & “A... Konstruksion” sh.p.k. Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

-Për mos mbajtje parasysh të kërkesave të UKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos trajtuar për secilin artikull, se ç’procedurë është ndjekur për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.

3. A.H. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues si dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mangësitë lidhur me zbatimin e hapave për rishikimin e strukturave menaxheriale, dhe për mos përmbushjen e detyrimeve, gjatë viteve 2012, 2013, 2014 lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, në 8 raste, në procedurat e prokurimit “Projektimi Ujësjiellës Babrru”, “Sistemi i Kolektorit të Shkarkimit të

liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9-vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2” , “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, “Blerje karburanti D1”, “Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër – Kodër e Kuqe Puseta”, “Riparim i rrugës “Demokracia”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim.

- Ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues” pika 54, pasi është kryer likuidimi i faturave tatimore të pashoqëruara me dokumentacionin përkatës si fletë hyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, në tenderin “Projektimi Ujësjellës Babrru”, “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan” dhe “Blerje karburanti D1”.

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa “d” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa “a” dhe “c”, pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve ekonomikë në 4 raste, në procedurat e prokurimit “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9-vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz”, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B.-I.”sh.p.k & “B...”sh.p.k & “A... Konstruktion” sh.p.k. Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

-Për arsye të mos ndjekjes së debitorëve dhe për mungesë bashkëpunimi dhe rakordimi të veprimeve midis Sektorit të Financës dhe atij Juridik. Lidhur me debitorët, ku totali i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit paraqitet për shumën 12,003,307 lekë, i trashëguar nga viti 2011, ku sipas partitarit të debitorëve, 939,213 lekë të shumës ishte e analizuar me 64 poste, detyrime të punonjësve për detyrat e vëna nga KLSH, etj. Përveç këtyre rezultojnë debitorë 6 shoqëri në shumë 5,880,136 lekë, prej vitit 2009, për të cilët nuk rezulton që të jenë ngritur padi civile në gjykatë. Pjesa tjetër e detyrimit prej 5,183,958 lekë nuk ishte e analizuar.

-Për arsye të mos ndjekjes së debitorëve dhe për mungesë bashkëpunimi dhe rakordimi të veprimeve midis Sektorit të Financës dhe atij Juridik. Lidhur me debitorët, ku totali i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit paraqitet për shumën 12,003,307 lekë, i trashëguar nga viti 2011, ku sipas partitarit të debitorëve, 939,213 lekë të shumës ishte e analizuar me 64 poste, detyrime të

punonjësve për detyrat e vëna nga KLSH, etj. Përveç këtyre rezultojnë debitorë 6 shoqëri në shumë 5,880,136 lekë, prej vitit 2009, për të cilët nuk rezultojnë që të jenë ngritur padi civile në gjykatë. Pjesa tjetër e detyrimit prej 5,183,958 lekë nuk ishte e analizuar.

4. B.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" ndryshuar, kreu II, pika 2, germa "c", pasi llogaritja e sasisë së mbetjeve urbane që prodhohen gjatë ditës nuk është e argumentuar dhe mbështetur në të dhëna zyrtare.

5. znj. L.H. anëtar i Komisionit të Asgjësimit të aktiveve

-Për mos mbajtje parasysh të kërkesave të UKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos analizuar dhe dokumentuar faktet, ngjarjet dhe veprimet e ndodhura, mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, siç edhe duhej bërë vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

6 .z. A.Gj. Inspektor i Tatim taksave

7. z. S.B. Inspektor i Tatim Taksave

8. z. Xh.L. Inspektor i Tatim Taksave

9. z. M.M. Inspektor i kontrollit

10. z. P.M. Inspektor i kontrollit

11. z. Sh.M. Inspektor terreni

-Nuk nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për subjektet debitorë nga viti 2012 deri në 6 e vitit 2014 për 481 subjekte debitorë në vlerë **8,449 mijë lekë, ne** në kundërshtim me ligjin me ligjin ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" nenit 12 të këtij ligji si dhe udhëzimi nr 24, datë 02.09.200, Kreu i XI "*Mbledhja me force e detyrimeve* pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3. dhe pika 96, është e analizuar.

II. "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për:

1. Z.L. me detyrë Përgjegjës Zyrës së Tatim-Taksave dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa "d" si dhe nenin 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa "a" dhe "c", pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit "*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*".

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim, në 3 raste, në procedurat e prokurimit "*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*".

“Sistemin, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër - Kodër e Kuqe Puseta” dhe “Riparim i rrugës “Demokracia”.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Sistemin, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz”*, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive **“B.-I.”sh.p.k & “B...”sh.p.k & A..Konstruksion” sh.p.k.** Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

-Nuk janë planifikuar saktë të ardhurave në vitin **2012** të, të taksës vendore të subjekteve të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, taksës pastrimit, taksës së regjistrimit, mos planifikim të takse popullatës, taksës ndërtesës (pasurisë)taksës së pastrimit në vlerën , të pa planifikuara total **16,000 mijë lekë.**

-Mos planifikim të saktë të ardhurave në vitin **2013** të taksës vendore të subjekteve të biznesit të vogël dhe i madh, taksës së pastrimit nga biznesi i vogël dhe te madh, mos planifikim te taksës popullatës së taksa e pasurisë total **10,488 mijë leke** të pa planifikuar

- mos planifikim të saktë të të ardhurave në vitin **2014** të taksës pastrimit të subjekteve të biznesit të vogël dhe te madh, mos planifikim te taksës pastrimit popullatës, taksa e pasurisë në vlerën në total **26,068 mijë lekë**, si e ardhur e pa planifikuar dhe e munguar.

-Nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për subjektet debitorë nga viti 2012 deri në 6 e vitit 2014 për 481 subjekte debitorë në vlerë **8,449 mijë lekë, ne** në kundërshtim me ligjin me ligjin ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” nenit 12 të këtij ligji si dhe udhëzimi nr 24, datë 02.09.200, Kreu i XI “Mbledhja me force e detyrimeve pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3. dhe pika 96, është e analizuar.

2. z. S.S inxhinier, anëtar i grupit të kolaudimit për;

. - Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në tenderin *“Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”*.

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e Prokurimit Publik”* ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”, pasi përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde nuk janë të plota, në tenderin *“Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”*.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Neni 46 *“Kualifikimi i ofertuesve”*, në 7 raste, në procedurat e prokurimit *“Projektimi Ujësjellës Babrru”*, *“Sistemi i Kolektorit të Shkarkimit të*

liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “*Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9-vjeçare Tahir Sinani*”, “*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*”, “*KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër*”, “*Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër – Kodër e Kuqe Puseta*”, dhe “*Riparim i rrugës “Demokracia”*”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim.

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa “d” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa “a” dhe “c”, pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve ekonomikë në 4 raste, në procedurat e prokurimit “*Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2*” “*Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9-vjeçare Tahir Sinani*”, “*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*”, “*KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër*”.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz*”, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsytim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “**B.-I.”sh.p.k & “B..”sh.p.k & A.. Konstruksion” sh.p.k.** Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

3. K.B. me detyrë Juriste dhe anëtare e Njesisë së Prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në procedurat e prokurimit “*Projektimi Ujësjiellës Babrru*”, “*Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2*”, “*Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9-vjeçare Tahir Sinani*”, “*Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2*”.

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është publikuar në sistem njoftimi i lidhjes së kontratës si dhe formulari i njoftimit të fituesit, në tenderin “*Projektimi Ujësjiellës Babrru*”.

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e Prokurimit Publik*” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”, pasi përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde në tenderin “*Projektimi Ujësjiellës Babrru*”, nuk janë të plota, nuk është kërkuar të paraqitet vërtetimi për pagesën e taksave vendore.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, në 2 raste, në procedurat

e prokurimit “*Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan*”, “*Blerje karburanti D1*”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim.

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” ndryshuar, kreu II, pika 2, germa “c”, pasi llogaritja e sasisë së mbetjeve urbane që prodhohen gjatë ditës nuk është e argumentuar dhe mbështetur në të dhëna zyrtare.

- Ka miratuar vendin e hedhjes së mbetjeve urbane në Kodër Babrru në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*” i ndryshuar, neni 10, pika 3 germa “f”, neni 11, pika “d”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”, ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “*Për mbrojtjen e mjedisit*” neni 1, ligjin nr. 10436, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e mbetjeve*” neni 5, germa “a” dhe “c” dhe nenin 21 pika 5, VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “*Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve*”, ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “*Për administrimin e mbetjeve të ngurta*”, pasi ka miratuar vendin e hedhjes së mbeturinave në Kodër Babrru.

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, nenin 24, pika 3, pasi nuk është mbajtur asnjë dokument si procesverbal, raport përmbledhës për anulimin e procedurës prokurimit në tenderin “*Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2*” dhe “*KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër*”.

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, nenin 43, pika 5 dhe, pasi nuk është respektuar afati i dorëzimit të dokumenteve për pjesëmarrje në tender në 2 raste, në tenderin “*Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2*” si dhe “*KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër*”.

- Nuk ka ndarje të detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, kreu V, pika 1, germa “a”.

- Në tenderin Blerje karburanti D1” nuk ka preventiv për përcaktimin e nevojave për karburant për vitin 2013 dhe në tenderin “Blerje materiale inerte” (Çakëll) nuk ka dokument që të tregojë se si është llogaritur çmimi i materialit inert, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, kreu II, pika 2, germa “c” dhe “ç”.

-Për arsye të mos ndjekjes së debitorëve dhe për mungesë bashkëpunimi dhe rakordimi të veprimeve midis Sektorit të Financës dhe atij Juridik. Lidhur lidhur me debitorët, ku totali i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit paraqitet për shumën 12,003,307 lekë, i trashëguar nga viti 2011, ku sipas partitarit të debitorëve, 939,213 lekë të shumës ishte e analizuar me 64 poste, detyrime të punonjësve për detyrat e vëna nga KLSH, etj. Përveç këtyre rezultojnë debitorë 6 shoqëri në shumë 5,880,136 lekë, prej vitit 2009, për të cilët nuk rezulton që të jenë ngritur padi civile në gjykatë.

4. S.H. me detyrë Përgjegjës i Shërbimeve dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, në 8 raste, në procedurat e prokurimit “Projektimi Ujësjiellës Babrru”, “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”, “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9- vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, “Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Babru Qendër – Kodër e Kuqe Puseta”, “Riparim i rrugës “Demokracia”, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim.

- Nuk ka përmbushur detyrat e tij funksionale për mbikëqyrjen e realizimit të shërbimeve në tenderin “Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”, në kundërshtim me VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, pika 2 “Mbikëqyrja e kontratës”, germa “a” dhe germa “b”.

- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 10, pika 3 germa “f”, neni 11, pika “d”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” neni 1, ligjin nr. 10436, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e mbetjeve” neni 5, germa “a” dhe “c” dhe nenin 21 pika 5, VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”, pasi ka miratuar vendin e hedhjes së mbeturinave në Kodër Babrru në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 1, pika 2, germa “d” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa “a” dhe “c”, në 4 raste, në procedurat e prokurimit “Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K.U.Z. në Paskuqan 2”, “Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9- vjeçare Tahir Sinani”, “Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”, “KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”, pasi është konstatuar trajtim i pabarabartë i operatorëve ekonomikë.

- Nuk ka përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave”, pasi nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe për vlerësimin e ofertave në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2013.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim, asfaltim, kanalizim, ndriçim rrugor në segmentin rrugor Paskuqan 2 Vreshtë Kufiri Kodër Kamëz”, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka evidentuar si konkurrent dhe nuk ka asnjë arsyetim për vlerësimin, apo shkualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B.&I.”sh.p.k & “B...”sh.p.k & A...Konstruksion” sh.p.k. Oferta e këtij bashkimi operatorësh ka një diferencë në vlerë prej **2,203,384 lekë** pa TVSH nga oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik.

5. Xh.Z. me detyrë Inxhinier sektori i Urbanistikës dhe njëkohësisht anëtar i Njesisë së Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në procedurat e prokurimit *“Projektimi Ujësjiellës Babrru”*, *“Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K. U. Z. në Paskuqan 2”*, *“Riparime, Lyerje, Shërbime në Shkollën 9- vjeçare Tahir Sinani”*, *“Rehabilitimi i kanalit kryesor të ujërave të bardha Paskuqan 2”*.
- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është publikuar në sistem njoftimi i lidhjes së kontratës si dhe formulari i njoftimit të fituesit, në tenderin *“Projektimi Ujësjiellës Babrru”*.
- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e Prokurimit Publik”* ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”, pasi përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde në tenderin *“Projektimi Ujësjiellës Babrru”*, nuk janë të plota, nuk është kërkuar të paraqitet vërtetimi për pagesën e taksave vendore.
- Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Neni 46 *“Kualifikimi i ofertuesve”*, pasi operatorët e shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim, në 2 raste, në procedurat e prokurimit *“Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”*, *“Blerje karburanti D1”*.
- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* ndryshuar, kreu II, pika 2, germa “c”, pasi llogaritja e sasisë së mbetjeve urbane që prodhohen gjatë ditës nuk është e argumentuar dhe mbështetur në të dhëna zyrtare.
- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, nenin 24, pika 3, pasi nuk është mbajtur asnjë dokument si procesverbal, raport përmbledhës për anulimin e procedurës prokurimit në tenderin *“Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K. U. Z. në Paskuqan 2”* dhe *“KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”*.
- Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, nenin 43, pika 5 dhe, pasi nuk është respektuar afati i dorëzimit të dokumenteve për pjesëmarrje në tender në procedurën e prokurimit *“Sistemimi i Kolektorit të Shkarkimit të liqenit dhe K. U. Z. në Paskuqan 2”* si dhe *“KUZ Paskuqan nr. 1 Qendër”*.
- Nuk ka ndarje të detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, kreut V, pika 1, germa “a”.
- Në tenderin *Blerje karburanti D1* nuk ka preventiv për përcaktimin e nevojave për karburant për vitin 2013 dhe në tenderin *“Blerje materiale inerte”* (Çakëll) nuk ka dokument që të tregojë se si është llogaritur çmimi i materialit inert, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, kreut II, pika 2, germa “c” dhe “ç”, (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 46-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
- Për mosmbajtje parasysh të kërkesave të VKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos analizuar dhe dokumentuar faktet, ngjarjet dhe veprimet e ndodhura,

mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, siç edhe duhej bërë vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

6. z. V.SH. Kryetar i Komisionit të vlerësimit të aktiveve

7. z. K.M. anëtar i Komisionit të vlerësimit të aktiveve

-Për mos mbajtje parasysh të kërkesave të UKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos analizuar dhe dokumentuar faktet, ngjarjet dhe veprimet e ndodhura, mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, siç edhe duhej bërë vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

8. z. Xh.D. Kryetar i Komisionit të Asgjësimit të aktiveve

9. z. K.H. anëtar i Komisionit të Asgjësimit të aktiveve

-Për mos mbajtje parasysh të kërkesave të UKM nr. 30, datë 27.12.2011, pikat 95-110, duke mos trajtuar për secilin artikull, se ç`procedurë është ndjekur për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.

C/3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR NGA DETYRA DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

a). Për 1 ish drejtues dhe specialistë nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur prej 6 muajsh nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, megjithatë për ta të njoftohet Departamenti i Administratës Publike.

“Vërejtje me shkrim”, përkatësisht për:

1. M.Sh. me detyrë ish-juriste dhe anëtare e Njesisë së Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar Kreu VI, pika 3, germa “ç”, pasi nuk është hedhur në sistem, si dhe nuk është printuar e bashkëngjitur dosjes tenderit formulari i shkualifikimit të operatorëve, në tenderin *“Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”*.

- Nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e Prokurimit Publik”* ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa “a”, pasi përcaktimet e bëra nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standarde nuk janë të plota, në procedurën e prokurimit *“Evadimi i mbetjeve urbane Komuna Paskuqan”*.